REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE-NATIONAL AUDIT OFFICE
23-06-2025

| Njësia Org. Org. Jedin. Org. Unit | Shif.klasif. Klasif. Kod Class. Code | Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No. | Nr.i faqeve Br. Stranica No. Pages |
|---|---|---|---|
| 03 | 47 | 1072 | 5 |

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH
Njësia Org. Org.Jedinica Org Unit 02
Nr.Prot: Broj Prot: Prot.No: 05-4760
Nr.i faqeve Br.stranica No.pages -5-
Data: Datum: Date: 20/06/2025
Prishtinë / a

# Republika e Kosovës

## Republika Kosova-Republic of Kosovo

*Qeveria–Vlada–Government*

**Ministria e Shëndetësisë-Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Health**

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm/Ured Stalnog Sekretara/Office of the Secretary General

| | |
|---|---|
| **DATË/A:** | **19.06.2025** |
| **PËR/ZA/TO:** | Znj.Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme |
| **NGA/OD/FROM:** | Dr. Naim Bardiqi, Sekretar i Përgjithshëm-Ministria e Shëndetësisë |
| **CC/** | Dr Arsim Berisha, Zv Minister i Shëndetësisë<br>Z.Demë Rexhepi, Udhëheqës i Njësisë së Auditimit të Brendshëm, Ministria e Shëndetësisë<br>Znj.Kadrije Berisha- Drejtor i Departamenit për Buxhet dhe Financa, Zyrtar Kryesor Financiar, Ministria e Shëndetësisë |
| **TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:** | Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve nga Raporti i ZKA për Ministrinë e Shëndetësisë për vitin e përfunduar 2024 |

E nderuar znj.Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme

Bazuar në Rregulloren e punës për zbatimin e Auditimit të planeve të veprimit e miratuar nga Auditori i Përgjithshëm neni 14 pika 1, brenda 30 ditëve nga pranimi i raportit të auditimit, entiteti i audituar dorëzon Auditorit të Përgjithshëm një Plan Veprimit për zbatimin e rekomandimeve. Bashkangjitur gjeni Plani i Veprimit për zbatimin e rekomandimeve nga Raporti i ZKA për Ministrinë e Shëndetësisë për vitin e përfunduar 2024.

Me respekt,

| | Ministria e Shëndetësisë<br>Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve nga Raporti i ZKA për Ministrinë e Shëndetësisë për vitin e përfunduar 2024 | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | **Raporti i Kapitujve** | **Institucionet përgjegjëse - Departamenti** | **Aktivitetet** | **Afati i Implementimit** | **Raporti i zbatimit** |
| | **3 Rekomandime** | | | | |
| | **2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë** | | | | |
| | **Çështja A1 -** Mangësi në procesin e prokurimit | | | | |
| | **Rekomandimi A1**<br><br>Ministri duhet të ndërmarrë masa për forcimin e kontrolleve të brendshme, me qëllim sigurimin e zbatimit të plotë të kërkesave ligjore gjatë përgatitjes dhe vlerësimit të tenderëve. | Njësia kërkuese<br><br>Divizioni i Prokurimit | Në zbatim të legjislacionit të Prokurimit Publik, akteve nënligjore, rregulloreve dhe udhëzimeve administrative, sipas Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), neni 28 kërkon që specifikimet teknike të jenë të qarta dhe të sakta, për të siguruar konkurrencë të barabartë.<br><br>Pika 7 ndalon çdo referencë direkte apo indirekte ndaj një prodhuesi, marke apo origjine, për të shmangur | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | favorizimet.<br><br>Sipas nenit 25.7 të Rregullores nr. 001/2022, Ministria e Shëndetësisë ndërmerr veprime përkatëse në zbatim të normave ligjore. Njësia kërkuese (zyrtari ,grupi punues,kompania) janë delegohet për inicimin e aktivitetit të prokurimit.<br><br>Njësia kërkuese nënshkruan deklaratën nën betim për zbatim të plotë të legjislacionit në fuqi..<br><br>Divizioni i Prokurimit obligohet t'i kërkojë njësisë kërkuese vëmendje që specifikimet teknike të mos jenë të ngushtuara dhe që, në përputhje me ligjin, të rishikohen.<br><br>Në rast të mosrespektimit të këtyre udhëzimeve, Divizioni i Prokurimit obligohet ta njoftojë njësinë kërkuese për shkeljet e konstatuara, ndërsa ZKA-ja ose zyrtari kompetent | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | të ndërmarrë veprimet përkatëse në përputhje me legjislacionin në fuqi.<br><br>Organi përgjegjës duhet të ndërmarrë veprimet përkatëse, duke përfshirë edhe njoftimin e organeve kompetente në rast dyshimi për shkelje penale. | | |
| | **2.2 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë** | | | | |
| | **2.2.1 Çështjet e përbashkëta për kategori të caktuara ekonomike** | | | | |
| | **Çështja A2** - Pasaktësi në prezantimin e informative | | | | |
| | **Rekomandimi A2**<br><br>Ministri duhet të siguroj kontrolle më të forta në përgatitjen e të dhënave në PVF, në mënyrë që ato të prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë. | Të gjitha programet | Raportimi i Llogarive të Arkëtueshme të bëhet cdo muaj deri me datën 5 të muajit pasues.<br><br>Drejtori/Udhëheqës i Administratës monitoron në baza mujore sistemin e E-pasurisë. | Shtator 2025<br><br>Dhjetor 2025 | |
| | **2.2.2 Detyrimet kontigjente** | | | | |
| | **Çështja A3** - Prezantim jo i saktë i detyrimeve kontigjente | | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | **Rekomandimi A3**<br><br>Ministri duhet të ndërmarrë masa për të vlerësuar me saktësi mundësitë e realizimit të detyrimeve kontigjente dhe për të përcaktuar një vlerë financiare të mundshme, për të ofruar një pamje të qartë dhe të drejtë të gjendjes financiare të organizatës. | Zyra e Sekretarit<br><br>Departamenti Ligjor<br><br>Departamenti për Buxhet dhe Financa<br><br>Departamenti i Sistemit të Informimit Shëndetësor | Vendimi i Sekretarit për formimin e komisionit për vlerësimin e vlerës financiare të Detyrimeve Kontigjente;<br><br>Komisioni do t'i identifikoj lëndët të cilat janë pa vlerë financiare;<br><br>Vlërësimi i përafërt do të bëhet nja njësitë;<br><br>Përditësimi i Sistemit të Detyrimeve Kontigjente;<br><br>Insertimi i të dhënave në sistem.<br><br>Detyrimet Kontigjente raportohen cdo muaj jo më larg se data 10 e muajit pasues te Zyrtari Kryesor Financiar dhe Zyrtari Kryesor Administrativ. | Qershor 2025<br><br>Shtator 2025<br><br>Shtator 2025<br><br>Shtator 2025<br><br>Tetor 2025<br><br>Raportim mujor | |